



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Datë: 16.04.2025
Numër Protokolli: 2755/2025

A.nr.411/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari, kryetare, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë, me Atdhe Gashi, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.411/2025, të datës 03.03.2025, të parashtruar nga ankuesi F.E., kundër organit të punësimit/ Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, në çështjen juridike “*kompensim material*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 16.04.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës *shpallet jo kompetent* për të shqyrtuar dhe vendosur lidhur me ankesën me numër A.nr.411/2025, të datës 03.03.2025, të parashtruar nga ankuesi, F.E.

II. Lënda i dërgohet për shqyrtim dhe vendosje organit kompetent/Komisionit për Ankesa të Ministrië së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë.

A r s y e t i m

Ankuesi, F.E (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi), më datë 03.03.2025 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me shifër Ref.02 Nr.25 dhe numër protokolli 469/02 të datës 07.02.2025, Ushtrueses së Detyrës të Sekretares së Përgjithshme të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) nga administrimi i shkresave të lëndës ka gjetur se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil

i Kosovës ***nuk është kompetent*** për të vendosur për ankesën me numër A.nr.411/2025, të datës 03.03.2025, të parashtruar nga ankuesi F.E., ***sepse***:

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se ankuesi, sipas Urdhër Gradimit me numër protokolli 576/6 të datës 27.02.2023, është i punësuar në pozitën OF-5 Kolonel, pranë Shtabit të Përgjithshëm të Forcës së Sigurisë së Kosovës-Ministria e Mbrojtjes. Si rrjedhojë, i njëjti përmes Vendimit me Nr.08/121 të datës 25.01.2023, të Kryeministrit të Republikës së Kosovës, është caktuar anëtar i Komisionit për Kontrollin e Tregtisë me Mallra Strategjike.

Tutje, sipas shkresave të lëndës rrjedh se kryesuesja e Komisionit për Kontrollin e Tregtisë me Mallra Strategjike, në emër të anëtarëve dhe zëvendës anëtarëve të këtij komisioni, më datë 08.01.2025 ka parashtruar kërkesë për kompensimin e mjeteve për funksion shtesë për periudhën nga muaji Mars 2023 deri në muajin Dhjetor 2024, tek Ushtruesja e Detyrës së Sekretares së Përgjithshme e Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë dhe Zyrtarja Kryesore Financiare.

Ndërsa, Ushtruesja e Detyrës e Sekretares së Përgjithshme të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë përmes Vendimit me shifër Ref.02 Nr.25 dhe numër protokolli 469/02 të datës 07.02.2025, ka refuzuar kërkesën për kompensim për punën shtesë të Komisionit për Kontrollin e Tregtisë me Mallra Strategjike.

Ankuesi, në ankesën e parashtruar në Këshill, pretendon se akti i kontestuar me ankesë është i pa ligjshëm dhe në kundërshtim me rregulloret përkatëse për kompensimin, ashtu që ka kërkuar nga Këshilli aprovimin e ankesës dhe funksioni i tij shtesë si anëtar i këtij Komisioni të kompensohet në mënyrë retroaktive nga muajit Shkurt 2023 deri në Shkurt 2025, duke llogaritur edhe kamat vonesën prej 8%, si dhe me detyrimin që ky kompensim të vazhdojë për periudhën pasuse deri në shfuqizimin e vendimit të caktimit të tij anëtar i këtij Komisioni.

Si rrjedhojë, duke u bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, me theks të veçantë duke ju referuar nenit 3 paragrafi 2 nën paragrafi 2.6 të këtij Ligjit, ku përcaktohet se: *2. Ky ligj gjithashtu nuk zbatohet edhe për kategoritë në vijim: 2.2. personelin komandues dhe ushtarak të Forcës së Sigurisë së Kosovës apo të organizatës tjetër pasardhëse*, Kolegji ka gjetur se të punësuarit në Forcën e Sigurisë së Kosovës janë të përjashtuar nga fusha e veprimit të ligjit për zyrtarët publikë, rrjedhimisht të punësuarit në institucionin e Forcës së Sigurisë së Kosovës ***nuk e kanë statusin e nëpunësit civil***, kështu që, në mbështetje të nenit 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ku përcaktohet se Këshilli është kompetent për të shqyrtuar vetëm ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për pranim në Shërbimin Civil, rezulton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.411/2025, të datës 03.03.2025 të parashtruar nga ankuesi, F.E.

Andaj, thënë si me sipër dhe duke u bazuar në dispozitat e nenit 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i

Këshillit vendosi që të shpallë veten jo kompetent për të vendosur lidhur me ankesën me numër A.nr.954/2024, të datës 02.07.2024.

Marrë parasysh konstatimin si më lartë se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk ka juridiksion për të vendosur lidhur me ankesën me numër A.nr.954/2024, të datës 02.07.2024, dhe meqenëse nga shkresat e lëndës vërehet se ankuesi nuk ka shfrytëzuar mjetet juridike në procedurë administrative pranë organit punëdhënës, Kolegji duke u bazuar në nenin 75 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative vendosi që lënda t'i dërgohet për shqyrtim dhe vendosje organit kompetent, në këtë rast Komisionit për Ankesa të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë.

Kështu që thënë si me sipër e në mbështetje të nenit 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr.06/L048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.411/2025

Atdhe GASHI

Procesmbajtës

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit F.E.;
- Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (U.D Sekretares se Përgjithshme dhe Njesisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë);
- Komisionit të Ankesave në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë; si dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së